**VENDIM**
**Nr.702, datë 10.11.2005**

**PËR PËRZGJEDHJEN E ORGANIZATAVE TË PUNËDHËNËSVE DHE TË SINDIKATAVE MË TË PËRFAQËSUARA NË KËSHILLIN ADMINISTRATIV TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave "b" e "c" të pikës 1 të nenit 72 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat më të përfaqësuara, që do të përzgjidhen për në këshillin administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, janë si më poshtë vijon:

A)

- Konfederata e Organizatave të Punëdhënësve (KOP);
- Bashkimi i Organizatave të Biznesit Shqiptar (BOBSH);
- Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë.

B)

- Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);
- Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);
- Unioni i Sindikatave të Punonjësve të Shqipërisë (USPSH).

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**